



Kuvendi i Komunës Klinë  
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi  
01Nr 06-61312 /24  
Klinë, dt 10.02 /24

## PROCESVERBAL

**Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 27.02.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.**

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSBB-së, në veçanti anëtarin e re, Natasa Dasic e cila zëvendëson Marko Nedelkovic dhe i falënderoi të gjithë për prezencën, ku theksoi që dy prej anëtarëve kanë lajmëruar që nuk do të jenë prezentë në këtë takim.

Unë gjatë këtij viti uroj punë të mbarë, shëndet dhe aktivitete të vazhdueshme të këtij Këshilli për Siguri në Bashkësi! Krahë meje është si gjithmonë komandanti i Policisë i cili nuk mungon asnjëherë, faleminderit për bashkëpunimin e vazhdueshëm që na jepni raportime për sigurinë në Komunën e Klinës. Në grupin e përbashkët që e kemi, jam e informuar që të gjithë e keni planin e KKSBB-së dhe njoftimin në email-et e juaja, por si gjithmonë unë do ta prezantoj rendin e ditës:

- 1. Prezantimi i Planit të punës për vitin 2024;*
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;*
- 3. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Klinës, ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet;*
- 4. Propozim për organizimin e trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave;*
- 5. Trajtimi i qenve endacakë;*
- 6. Të ndryshme.*

*Pika 1. Prezantimi i Planit të punës për vitin 2024.*

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Planin e punës të cilin e kemi punuar, jam munduar që sipas takimit të fundit që e kishim në 2023-tën të marr idetë e juaja që ta pasurojmë planin e këtij Këshilli. Përpos ideve që i kishit gjatë takimeve, askush nuk ka shkruar në grup ose në email për ndonjë ide, megjithatë, planin e kemi punuar dhe miratohet në asamblenë Komunale të Klinës dhe ky plan i ka kryesisht pothuajse të gjitha temat që i ka pasur edhe plani i viteve të mëparshme, sepse prapë vazhdoj ta them se siguria në komunë është po prapë e njëjta edhe kriteret dhe objektivat janë të njëjtat. Megjithatë, nga përfaqësuesi i ministrisë përkatëse na është dhënë si rekomandim që të kemi një plan të përbashkët me shumë komuna të tjera nga ai plan si model i përbashkët. Unë jam munduar që t'i nxjerr prapë disa nga temat që pothuajse i kemi kaluar në këto dy vitet që kaloi, por mënyra e planit është pak më e përshtatshme, temat janë të ndara në 6 takime të cilat kanë objektivat e veta, temat kryesisht të gjitha janë të sigurisë. Për këtë muaj i keni pikat e rendit të ditës, ndërsa në muajin prill kemi analizimin e vjedhjeve në komunën e Klinës, këtu sigurisht komandanti i Policisë e ka raportin.

Mungesa e trotuareve dhe shenjave të sinjalizimit, identifikimi dhe lirimi i hapësirave, mandej aktivitete që zhvillohen në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, përgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve të mbrojtjes ndaj zjarrit gjatë sezonit të verës, trajtimi dhe mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegal, informatë dhe analizë nga Policia e komunës rreth çështjes së sigurisë së përgjithshme, identifikimi i hapësirave për qasje të personave me nevoja të veçanta, organizimi i fushatave vetëdijesuese përmes aktiviteteve rekreative kulturore dhe përmirësimi i komunikimit ndëretnik fetar, siguria në trafik, vetëdijesimi i rrezikut të përdorimit të mjeteve piroteknike, masat e parandalimit të lëmshkërkuesve dhe për fund në përfundim të vitit e kemi lënë në dhjetor të punojmë prapë për përgatitjen e planit, e kemi lënë si pikë të rendit të ditës për përgatitjen e planit të KKSB-së. Në takimin e fundit në dhjetor, bashkë do ta kemi një pikë të rendit të ditës ku do të flasim për planin e vitit pasues të vitit 2025, diku deri në 70% janë tema që ne i kemi diskutuar.

Mënyra se si e kemi trajtuar KKSB-në është vlerësuar ndër 4 komunat më të suksesshme në Republikën e Kosovës dhe kjo na ka bërë të ndihemi mirë të gjithë, jo vetëm mua si zv. Kryesuese por ky sukses ka ardhur nga puna dhe aktivizimi juaj sepse të gjithë e dimë se deri më tani KKSB-ja ka mangësitë e veta në organizim sepse nuk bëhet pagesa e anëtarëve të KKSB-së dhe puna e juaj ka mbetur në mënyrë vullnetare, por, shpresoj shumë që në ditët në vazhdim nëse të gjithë koordinohemi, sepse edhe ju duhet të jeni goxha aktiv në kërkesa të mëditjes tuaj se është shumë normale dhe unë jam pro juve. Kjo mbetet të shihet në ditët në vazhdim dhe besoj shumë që edhe kjo do të rregullohet duke shpresuar që ky plan të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Ju uroj sukses dhe uroj shumë që të jeni aktiv po aq sa vitet e kaluara, ajo që është më e rëndësishmja është që neve na duhet të jemi prezentë sepse sido që të sillen situatat ne jemi të obliguar të ju ofrojmë qytetarëve tanë siguri. Unë, personalisht, komandanti i Policisë dhe drejtori i Arsimit, që jemi tre anëtarë të cilët përballemi para jush, do të mundohemi që kërkesat e juaja t'i shqyrtojmë dhe t'i dërgojmë në vendin e duhur.

**Z. Fitim Bojaj, hoxhë:** Përshëndetje, nënkryetare, para se të fillojmë e kemi një kërkesë:

që kjo mbledhje të kthehet në orar të punës sepse kështu ka qenë edhe përpara. Ka qenë në orar të punës dhe kanë thënë puna e pagesës dhe kemi bërë tolerime për disa, ne jemi që 20 vite këtu dhe vazhdojmë të japim kontributin, por në orar të punës. Unë bisedova edhe me FSK-në dhe orari është i gjatë, deri në ora 19:30 nuk mbërrimë në shtëpi dhe të jemi të sinqertë më në këtë orar nuk do të vijmë.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, hoxhë! Më vjen shumë keq se unë orarin nuk e kam rregulluar, kështu e kam gjetur orarin edhe planin, mandej kam ndërhyrë me tema të caktuara, mirëpo për kohën duhet diskutuar, përndryshe, vetëm edhe një sqarim: ajo që është bërë si kërkesë që të jetë ora 16:00 pas orarit, ka qenë arsyeja nën një që anëtarët e KKSB-së dhe jo të gjithë gjatë orarit të punës janë të lirë dhe që mund të vijnë, për këtë arsye është marr kriter, po mendoj ashtu, se unë e kam gjetur të tillë. Arsye tjetër ka qenë pagesa e cila realizohet si mëditje jashtë orarit të punës, kjo ka qenë mënyra që unë nuk e kam lëvizur orarin me shpresën që këto pagesa të ju kryhen dhe nëse këto aktivitete kryhen gjatë orarit të punës nuk besoj që mëditja paguhet. Megjithatë, ne të gjithë bashkë do të mundohemi të gjejmë një zgjidhje e cila ndoshta jo gjithmonë ju përshtatet të gjithëve, sepse personalisht mua më konvenon që ky takim të jetë në ora 14:00 ose në 15:00 edhe të përfundojë në ora 16:00, sepse unë nuk jam pjesë e pagesave ose më mirë të them nuk kam qenë, por ajo që unë kam dashur të bëj është që anëtarët e KKSB-së të marrin pagesat sikur Komitetet tjera. Megjithatë, unë do ta trajtoj me shumë seriozitet këtë çështje, të shohim se çka do të ndodh. Nëse ka edhe ndokush tjetër, nëse jo, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

### ***Pika 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.***

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Besoj që të gjithë i keni procesverbalet në email dhe keni pasur kohë që ta lexoni, dhe nëse ka dikush diçka që nuk është shënuar në procesverbal lirisht mund të diskutoni, nëse është gjithçka në rregull atëherë vazhdojmë me miratimin e procesverbalit dhe kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës.

### ***Pika 3. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Klinës, ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet.***

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Është tema për sigurinë në qytetin tonë, ku komandanti na raporton dhe na jep detaje për aktivitetet që janë shënuar.

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Faleminderit, nënkryetare, përshëndetje për të gjithë, për pjesëmarrësit e rinj mirë se kanë ardhur! Zonën tonë të përgjithësisë e kanë karakterizuar një sërë aktivitetesh të shumta, ku prej atyre aktiviteteve kanë pasur rezultate evidente. Sa për kureshtje në stacionin policor vlerësohemi në bazë të statistikave dhe në bazë të

statistikave që kemi dalë për vitin kalendarik 2023 në regjion jemi stacioni më i mirë dhe në nivel të Kosovës një ndër stacionet më të mira.

Për kuriozitet do të ju informoj në pika të shkurtra, sa i përket rasteve që kanë ndodhur dmth për 2023, në stacionin tonë janë paraqitur 676 incidente të natyrave të ndryshme, prej gjitha këtyre rasteve 385 raste janë vepra penale, zbulueshmëria e veprave penale është 83,6% që është një statistikë jashtëzakonisht e mirë. Në zonën tonë të përgjithësisë i kemi pasur 309 aksidente, ku 50 prej tyre kanë qenë me lëndime dhe 259 aksidente me dëme materiale, prej këtyre aksidenteve 108 persona kanë qenë të lënduar. Janë shqiptuar 8,681 gjoba, janë arrestuar 403 persona në ndalime policore dhe paraburgim, janë ndaluar 91 persona, janë konfiskuar 40 armë të ndryshme; rreth 400 copë municion të kalibrave të ndryshëm, janë realizuar diku rreth 40 asistime jashtë policore, prej incidenteve që vlen të ceket fatkeqësisht e kemi pasur një rast të vrasjes në qendër këtu në Klinë, i kemi pasur 2 raste të rënda të lëndimeve trupore, 44 lëndime të lehta trupore, 36 vjedhje, 41 vjedhje të rënda, 37 raste të dhunës në familje, janë realizuar rreth 400 urdhëresa të gjykatës, 836 patrullime këmbë dhe 1700 patrullime me vetura. Ka qenë një vit jashtëzakonisht i suksesshëm dhe këto vlerësohen në bazë të statistikave që janë nxjerrë.

Planin e punës për vitin 2024 veç kemi filluar me implementuar, momentalisht jemi në fazën e implementimit të planit operativ. Sensibilizimi i këmbësorëve dhe nuk e di nëse i keni vërejtur policët, që prej ditës së djeshme kemi filluar me bashkëbiseduar edhe me këmbësorë, në këto tri ditët e para nuk do të shqiptojmë shumë gjoba, por pas ditës së tretë do të filloj shqiptimi i gjobave në mënyrë që qytetarët të edukohen dhe të lëvizin në pjesën e rrugës aty ku është e destinuar lëvizja për këmbësorët. Mangësi në këtë pjesë që unë kam pritur që ta cekim dhe me dal si të dala nga ky takim janë vendkalimet për këmbësorët, ku siç jeni dëshmitarë të gjithë, vendkalimet për këmbësorët vitin e kaluar janë vendosur ato shiritat e rinj, por për shkak të reshurave, ato pothuajse veç kanë filluar të zhduken dhe kërkoj këtu nëse edhe ju pajtohen, i kjo pikë të jetë si e dalë prej këtij takimi dhe në ditët vijuese besoj që këtë problematikë me dërguar në vendin përkatës dhe me kërkuar sa më shpejtë që është e mundur, nëse ekziston kontrata në fuqi, me dal kompanitë përgjegjëse dhe me e mbushur sinjalizimin për vendkalim të këmbësorëve.

Jemi në fazën përgatitore të projektit për parandalimin e dukurive të zjarrit. E pash që është edhe pikë e rendit që do të diskutohet bashkërisht me institucionet përgjegjëse. Sikur vitet e tjera paraprake edhe këtë vit do të fillojmë qysh herët t'i trajtojmë dhe do të fillojmë me disa ligjërata nëpër shkolla. Normalisht që ligjëratat për vetëdijesimin e nxënësve kanë filluar në disa shkolla, janë tema të planifikuara nga niveli qendror të Drejtorisë së Policisë. Fatmirësisht, deri më tani këtë vit kalendarik nuk kemi pasur ndonjë rast të ndjeshëm dhe jemi duke e realizuar atë çka është më e mira, dhe çka unë kërkoj këtu është që grupi ynë të jenë pak më të zëshëm në drejtimin e çështjeve negative dhe burimeve negative dhe aty ku ju mendoni që duhet me bërë ndonjë ndryshim apo ndonjë propozim, grupin në viber e kemi, komunikimi besoj që s'na mungon dhe nga ju të na përkrahni në këtë drejtim dhe me dhënë sugjerime. Kjo ishte në pika të shkurtra, ju faleminderit!

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, komandant! Nëse ka dikush diçka të shtojë në këtë pikë, po Silvia?

**Znj. Silvia Rashkoviq:** Përshëndetje për të gjithë dhe anëtarëve të rinj ju uroj mirëseardhje!  
Kam një pyetje për komandantin e Policisë me rastin e fundit që ndodhi në Binxhë në dy familje.

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Po, kemi informacion. Javën e kaluar kemi vepruar, patrulla policore ju ka përgjigjur një ftese, një informate, që është dëgjuar një krismë në atë zonë. Patrulla policore ju ka përgjigjur rastit, ka shkuar te ankuesi dhe bashkë me të kanë dalë natën dhe e kanë inspektuar vendin e ngjarjes dhe nuk ka pasur diçka të dyshimtë pos asaj informate. Ditën vijuese hetuesit prapë kanë shkuar dhe sipas ankuesit thotë: “kam dal me shikuar një dele aty që i ka lind dhe kam dashur me i kontrolluar delet dhe e kam dëgjuar një zë dukë thënë ik se po na sheh dhe janë larguar, sipas tij”, mirëpo, diçka e dyshimtë në vendin e ngjarjes nuk është vërejtur. Patrullat mbremë u janë përgjigjur rastit të zjarrvënies, ku një qytetar i fshatit Binxhë ka qenë në Serbi dhe ditën vijuese që ka ardhur e ka vërejtur që stalla ku e ruan ushqimin për bagëti ju ka djegur kulmi me rreth 1,000 duaj sanë dhe hetuesit sot akoma janë në terren. Jemi në fazën e përfundimit të dëshmive, deri më tani nuk ka diçka të dyshimtë, ne rastin e kemi kategorizuar si zjarrvënie e qëllimshme dhe jemi në fazën e hetimeve, kjo është në pika të shkurta.

#### ***Pika 4. Propozim për organizimin e trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave.***

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Mua më pëlqej fakti që komandanti na lajmëroj që e kanë një plan të veprimit të tillë, plan i cili koordinohet me planin e KKSB-së dhe jam e sigurtë që Drejtoria e Arsimit i ka ato përgatitjet e veta dhe është gjithmonë e gatshme të bashkëpunojë me institucionet, siç janë Policia, mandej pjesë tjetër është institucioni i zjarrfikësve të cilët duhet të jenë bashkë në këto aktivitete. Ne të gjithë e dimë se nëpër shkolla shpeshherë mund të ndodhin situata dhe nxënësit tanë mund të jenë të papërgatitur dhe kjo është mënyra më e mirë që në një formë të organizohen trajnime të ndryshme që i përgatisin nxënësit të mbrohen ose të dinë të japin ndihmën e parë në raste të tilla. Synimi kryesor është dhënia e ndihmës së parë, por unë mendoj që objektivi kryesor është që nxënësit të motivohen ose të vetëdijesohen e mos të shkaktojnë zjarre, mandej të dinë të mbrohen nga zjarret, të dinë të përdorin aparatet e zjarrfikjes etj. Duke qenë pjesë e arsimit për disa vite unë e kam parë se sa janë të nevojshme, dhashtë Zoti që të mos kemi probleme të tilla, po nxënësit duke mos qenë të vetëdijshëm shpeshherë i zbraznin aparatet e zjarrit. Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë, të japim iniciativa të cilat vinë sipas planit, mirëpo, më vjen mirë që plani ynë është në koordinim me planin që e ka edhe Policia dhe Drejtoria e Arsimit është pjesë e pandashme e jona, e cila i ka këto aktivitete të përbashkëta me ne, pasi komandanti na tha që kanë një plan do të ishte mirë të na tregojë formën dhe nëse ka dikush tjetër diçka, pastaj të shtojë ose të jap ndonjë ide që faktikisht ky propozim del edhe rekomandim dhe shohim çka tutje për këtë vit.

**Z. Qemajl Sejdiq, drejtor i DKA-së:** Faleminderit, nënkryetare, i nderuari komandant, të nderuar anëtarë! Realisht, Drejtoria e Arsimit, vit pas viti në bashkëpunim me policinë e Kosovës ka ligjërata të ndryshme, duke e përfshirë komplet sigurinë, duke e përfshirë edhe forcën e sigurisë tonë të Kosovës. Ne, në vazhdimësi edhe pse janë të parapara në plan, ne kemi ligjërata

në bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe është mirë këto ligjërata të vazhdojnë dhe të ketë bashkëpunim edhe në vazhdimësi, sepse nxënësit së pari është mirë me qenë të informuar se çka janë ato, sepse ka pasur raste më herët që edhe ju ka skaduar afati atyre aparateve, por, që sot fatmirësisht jemi në rregull me atë pjesë. Kemi probleme p.sh., me daljet emergjente se ne e dimë që këto lidhen komplet me sigurinë dhe zjarrvënien, objektet e reja shkollore fatmirësisht i kanë të parapara. Ne kemi shumë objekte në komunën e Klinës që nuk i kanë të parapara daljet emergjente dhe ne duhet me punuar në atë drejtim që ne me i kryer punët tona. Unë dua ta falënderoj Policinë e Kosovës dhe krejt çka janë pjesë e sigurisë në Kosovë, me të vërtetë po e bëjmë atë që po mundemi, me qenë afër nxënësve dhe sado pak ata me qenë të informuar. Ju faleminderit për kohën!

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Po, komandant, urdhëro

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Mbi formën e realizimit të këtij projekti, ne, në bashkëveprim me Drejtorinë e Arsimit, me komandantin dhe pjesëtarët e zjarrfikësve, mbajmë ligjërata nëpër shkolla dhe në qendër të qytetit, me theks të veçantë para sezonit veror, kur temperaturat kanë ngritje, ne, në vazhdimësi jua sqarojmë se çka do të thotë përdorimi i zjarreve, me theks të veçantë në kohën e temperaturave kur është mbi 30 gradë dhe mendoj që përmes atyre ligjëratave sensibilizohen rinia, nxënësit që të kenë kujdes gjatë sezonit veror.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit, komandant! Nëse ka dikush tjetër?

**Znj. Diana Kerellaj:** Përhëndetje, unë jam anëtare e KKSB-së! Kërkesa ime është për komandantin e Policisë ose ndoshta një sugjerim; kisha pasur dëshirë që në fshatin Klinafç ka të kthyer jo shumicë dhe kisha pasur dëshirë që aty ta vendosin ndonjë kamerë, ju faleminderit.

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Ne, këtë vit, bashkë me kryetarin dhe stafin e komunës, jemi duke u përpjekur maksimalisht që sistemin e kamerave në qytet ta rregullojmë. Ky është investim i komunës dhe nëse mund të marrim ndonjë donacion, përndryshe policia nuk mund të vendos kamera, por vetëm komuna dhe normalisht ato vendosen në mbikëqyrjen tonë, por shpresojmë ta shtjellojmë këtë mundësi.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit, komandant! Ne po dalim edhe me këtë rekomandim; vendosja e kamerave në zona të rrezikut. E tha edhe komandanti se, ne si komunë, jemi të fokusuar ose kamerat janë të vendosura në qytet dhe është e vështirë të vendosen edhe në fshatra, sepse është një kosto shumë e lartë, por, do të jemi të vëmendshëm për disa zona, ashtu siç e theksoi më herët Diana, sepse në atë zonë janë komunitet të cilët janë kthyer nga vendet e huaja dhe aty paraqitet problem. Aty, faktikisht nuk është problem vetëm siguria, aty kemi edhe probleme me fëmijë që nuk e vijnë shkollimin, fëmijë të cilët janë lëmshë kërkues dhe është zonë më problematike. Të falënderoj shumë për kërkesën dhe uroj shumë të realizohet!

### ***Pika 5. Trajtimi i qenve endacakë.***

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faktikisht këtë temë e kemi diskutuar në muajin dhjetor, por sipas planit na ka ardhur prapë në fillim të këtij takimi dhe nuk është asnjëherë e tepërt të diskutojmë për këto tema, për këto probleme të cilat kanosin rrezikun e qytetarëve. Qentë endacakë sado që trajtohen sipas planit nga drejtorja përkatëse e cila e ka një projekt të vazhdueshëm dhe po mundohet që të kryej të gjitha obligimet që ka, prapë se prapë, qentë janë rrugës dhe rreziku është potencial dhe ne vet si qytetarë të lirë kur kalojmë e shohim se ata paraqesin problem, sidomos për pleqtë dhe fëmijët. Kompania përgjegjëse e implementimit të projektit, bashkë me drejtorinë përkatëse, po i përfundojnë të gjitha aktivitetet e parapara sipas planit dhe po vazhdon dhe në takimin e radhës. Unë besoj që do të raportoj për gjendjen e aktivitetit që është zhvilluar në lidhje me këtë projekt, jam shumë e sigurt sepse ky plan është dy vjeçar dhe besoj që do të implementohet edhe pjesa tjetër e planit. Nëse ka dikush diçka ose ndonjë zonë të caktuar se ku është rreziku, do të ishte mirë me marr ndonjë informatë të tillë nga ju, nëse nuk ka, atëherë kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës.

### ***Pika 6. Të ndryshme.***

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Kjo është pikë e cila unë ju lë të lirë për ndonjë gjë që ju keni për të diskutuar, për të dhënë ndonjë ide, sugjerim ose për të paraqitur ndonjë shqetësim ose kërkesë.

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Edhe unë e kisha përkrahur fuqishëm hoxhën, kur tha më herët për orarin e takimit, që të jetë në orarin e punës 08:00-16:00, sepse ky orar po na merr pak kohë dhe ne jetojmë jashtë Klinës me kolegët e FSK-së. Kështu që, kërkoj që përderisa nuk bëhet pagesa për anëtarët, ky takim të jetë brenda orarit të punës.


**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Atëherë, ne të gjithë jemi bashkë për Siguri dhe Bashkësi, prapë po e them se nuk është qëndrim i imi personal, por pyetja ime është kjo: nëse pagesa juaj zhvillohet, nëse takimi mbahet pas orës 16:00, po ju pyes unë ju se a ta lë në të njëjtin orë takimin? Sepse, p.sh., FSK-ja, KFOR-i, OSB-ja, janë organizata që nuk paguhen, as komandanti i Policisë e as unë, kështu që, duke qenë pjesë e këtyre, unë jam e sigurt që na konvenon deri në ora 16:00. Po ata të tjerët të KKS-së të cilët mund të marrin pagesë dhe sipas ligjit rrinë në fuqi kjo pagesë, kjo pagesë duhet të jetë si bazë e normës e pagës 20 deri në 30% e pagës. Unë dua të jem e sinqertë me ju sepse pjesa tjetër mund ta humb këtë mundësi të pagës së tyre, unë do të jem shumë e vëmendshme dhe do ta analizoj edhe në komuna tjera, e kuptoj shqetësimin tuaj dhe do ta marr shumë seriozisht këtë punë.

**Z. Shemsi Bajraktari:** Unë desha ta bëj një sqarim shtesë, se mandatin e kaluar kam qenë koordinator i KKSBB-së dhe ka qenë iniciativë e imja që takimi të mbahet në ora 16:00 për arsye sepse kemi pasur shumë probleme për pagesat me Ministrinë e Financave, dmth 4-5 pagesa të anëtarëve janë bërë, 4-5 nuk janë bërë dhe për këtë arsye është vendosur ky orar, që të mos kenë arsye që të mos e bëjnë pagesën. Por, tash me Ligjin e ri të pagave jemi duke pasur prapë probleme, por shpresoj që koordinitorja bashkë me nënkryetaren do të merren me këtë çështjen e pagesës.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë! Atëherë, fajtorin e orës 16:00 e gjetët dhe se unë jam e pafajshme. Ne, gjithçka do të bëjmë bashkërisht dhe do të interesohemi rreth çështjes së pagesës, sepse sa e di unë disa komuna veç kanë filluar me pagesë sepse është e ligjshme dhe unë do ta shqyrtoj, do ta analizoj ne do të bisedojmë rreth kësaj çështje.

Nënkryetarja e përmbylli takimin duke i përshëndetur të gjithë anëtarët që ishin prezent dhe duke i falënderuar për angazhim.

**Procesmbajtësja,  
Orgeta Sylaj**



**Zv. KRYESUESJA,  
Marqe Tanushi-Selmanaj**

